



SHLUIJ “UNIVERSITETI
MARIN BARLETI”

Guidë instruktive për mbështetjen dhe pasurimin e mësimdhënies *on-line*

Mars, 2020

Guida instruktive për mbështetjen dhe pasurimin e mësimdhënies *on-line*, u hartua enkas për mbështetjen e mësimit *on-line* në situatën e krijuar në vend, për shkak të *Corvid-19* dhe mbylljes zyrtare të procesit mësimor të drejtpërdrejtë.

Ky material orientues synon të lehtësojë profesionalisht stafin akademik të UMB për të përfunduar me sukses realizimin e orëve mësimore, sipas programeve lëndore dhe orareve mësimore të semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020.

Guida është një përpyetje profesionale për t'i sjellë stafi akademik i UMB metoda teknika dhe strategji të efektshme për mësimdhënien *on-line*, duke pasur në fokus dhënien e leksioneve, nxitjen e diskutimeve dhe reagimeve të studentëve për të nxënëit e tyre, por dhe mundëson zbatimin e teknikave të efektshme të vlerësimit, për nxitjen e të nxënëit dhe matjen e arritjeve të studentëve.

Metodat e sugjeruara për përdorim gjatë mësimit *on-line*, bazohen kryesisht në format e njohura të ndërveprimit *on-line*, si: *Google Classroom*, *Skype*, *Google Hangouts Meet*, etj., të cilat pjesa më e madhe e stafit ynë akademik i përdor në procesin mësimor, por Guida paraqet dhe teknologji të tjera virtuale që mund të krijohen nga ndërveprimi *on-line* pedagog-student, për të pasuruar mësimdhënien dhe të nxënëit *on-line*.

Guida synon të kombinojë metodën tradicionale “ballë për ballë” me format *on-line* të mësimit, në mënyrë që të krijojë mundësi që të shpjegohen konceptet themelore të leksioneve, të punohet mbi ushtrime, probleme, teori, mbi situata rasti/studimore, etj., sipas specifikave të lëndëve/moduleve, por dhe paraqet teknika që mundësojnë vlerësimin e studentëve gjatë procesit të mësimdhënies, si dhe në përfundim të modulit apo lëndës.

Idetë, praktikat e mira të sugjeruara në këtë Guidë mund të pasurohen dhe nga aftësitë dhe kompetencat e pedagogëve tanë, të cilat janë të mirëpritura në vijimësi.

Guida është përgatitur nga **Dr. Robert GJEDIA**, **Dr. Migena KAPLLANAJ**, **Dr Shpëtim CAMI**, **Dr. Elona MEHMETI**, grup pune (sipas dokumentit “*Mbi procesin mësimor në distancë*” Nr. 1, datë 25.03.2020 (pika 4) që është asistuar nga komunikimi me Prof.As. Dr Arbana KADRIU dhe Msc. Esmeralda KAZIA dhe është miratuar nga Rektori.

Udhëzime metodologjike për të pasuruar mësimdhënien *on-line* gjatë periudhës së mbylljes së procesit mësimor

Në një botë digjitale asnjë organizatë nuk mund të arrijë rezultate pa përfshirjen e teknologjisë në çdo aspekt të praktikave të përditshme. Është pikërisht momenti për të maksimizuar sa më mirë ndikimin e përdorimit të TIK në proceset e mësimdhënies dhe të të nxënit për pedagogët dhe studentët.

Zhvillimi i mësimdhënies dhe të nxënit *on-line* sugjerohet të përfshijë vendimet e pedagogut rreth tri elementeve, të ndërlidhura ngushtësisht me përmbajtjen e lëndës/modulit dhe me proceset e mësimdhënies dhe të nxënit *on-line*.

Ato janë:

1. **Përmbajtja e leksionit** (çfarë do të trajtojë leksioni). Pedagogu¹ paraqet dhe thotë, në mënyrë shumë të përmbledhur, konceptet² që do të trajtohen, të cilat mund të paraqiten *on-line* dhe me pika kyçe.
Leksionet e plota duhet të jenë në versionin pdf, ppt dhe u nisen studentëve me e-mail.
2. **Rezultatet e të nxënit** që do të arrijnë studentët për leksionin, shkruhen të qarta dhe të sakta³ dhe marrin në konsideratë nivelet e ndryshme të arritjeve të studentëve, në mënyrë që të përfshihen të gjithë studentët të nxënë. Pedagogu i thotë ato në komunikimin *on-line*, duke i lidhur dhe me metodat dhe procedurat se si studentët do të demonstrojnë përmbushjen e rezultateve.
3. **Vlerësimi i rezultateve të të nxënit** Pedagogu në mësimdhënien *on-line* e përdor vlerësimin si shtysë për të nxënit, por dhe si matje e nivelit real të të nxënit të studentëve.

¹ Në çdo rast përdorimi në këtë material fjala pedagogu nënkupton dhe pedagogen

² Koncepti nënkupton teorinë, situatën, përmbajtjen, pikëpamjet, këndvështrimet, llojet e ushtrimeve apo problemave, skicave apo ngjarjeve, videove, etj ,pra gjithë çka që ka si përmbajtje akademike leksioni.

³ Rezultati ndërtohet nga tri pjesë, të tilla, si: Kriteri 1: Folje veprorë e vëzhgueshme, e matshme dhe e arritshme; Kriteri 2: Përmbajtja që ka të bëjë me konceptet që do të mësohen; Kriteri 3: cilësia, që nënkupton nivelin e përmbushjes së rezultatit nga ana e studentëve.

METODA TË FRYTSHME PËR MËSIMDHËNIEN *ON-LINE*

Metodat, teknika dhe strategjitë e mësimit *on-line* janë të shumëllojshme, por nisur nga konteksti dhe mundësia që ne kemi, sugjerojmë përdorimin dhe kombinimin e metodave të mëposhtme, të cilat gjykojmë se sigurojnë një komunikim aktiv *on-line* me studentët, si dhe lehtësojnë procesin e mësimit dhe të nxënies. Nga ana tjetër, gjykojmë se për disa metoda, shumica e pedagogëve kanë mundësi t'i zbatojnë, disa të tjera dhe mund t'i zbatojnë në punë e sipër. Qëllimi i vetëm i tyre është të nxiten të nxëniet të studentët në kushtet dhe rrethanat, ku mësimi i drejtpërdrejtë është ndërprerë.

Mësimdhënia *on-line* mund të zhvillohet sipas lëndëve, orarit, dhe leksioneve javë pas jave dhe synon që për rezultatet që u jepen studentëve paraprakisht, ata të punojnë për arritjen e tyre.

Përveç pedagogëve të brendshëm që do ta fillojnë menjëherë këtë ndërveprim *on-line* me studentët, në këtë proces duhen përfshirë dhe pedagogët me kohë të pjesshme.

Drejtuuesi i Departamentit, koordinatori dhe Sekretaria Mësimore, asistojnë pedagogët e jashtëm me informacionet e nevojshme në lidhje me të dhënat e studentëve dhe krijimin e kontakteve të nevojshme me ta.

Mësimdhënia *on-line* duhet të motivojë studentët që të eksplorojnë edhe burime të tjera *on-line* si video ilustruese, filma me tematika të lidhura me leksionet ose libra etj. që janë të disponueshëm *on-line*.

Ndërveprimi *on-line* pedagog-student, jo vetëm që nxit të lexuarin dhe përvetësimin e më shumë njohurive, por edhe zhvillon aftësitë e tyre për eksplorimin e burimeve.

1. METODA E MËSIMDHËNIES *ON-LINE* NËPËRMJET *SKYPE*.

Përdorimi i kësaj metode kryesisht synon të realizojë numrin e orëve të leksioneve sipas programit të lëndës/modulit.

Pedagogu ndjek këto hapa:

- 1.1 Pedagogu dhe studentët komunikojnë të gjithë dhe takohen në të njëjtin orar në një grup të përbashkët. Gjatë leksioneve të gjithë studentët e mbyllin mikrofonin në mënyrë që të

mos krijohet interferencë. Kush ka pyetje shkruan në komente. Lidhja e parë mund të jetë pak e vështirë, ndaj sugjerohet që herën e parë të fillohet 30 minuta më herët.

- 1.2 Leksioni në *power point* apo sipas pikave kryesore mund të bëhet *share screen* dhe të gjithë studentët shohin të njëjtin dokument/video apo material ilustrues.
- 1.3 Shpjegimi me *ppt* të jetë maksimumi 15-20 minuta ku paraqiten konceptet themelore të temës/leksionit.
- 1.4 Do të jetë mirë të jepen ushtrime, pyetje, detyra për çdo leksion (nga 1 - 2 të tilla) që lidhen me ngushtë me të nxënit e leksionit dhe në mënyrë të tillë të veprohet për leksion pas leksionit.
- 1.5 Mund të jepen dhe detyra apo ushtrime për një grup-temash/leksionesh mësimore, që bazohen te konceptet kryesore më të rëndësishme.
- 1.6 Studime të rastit dhe analizat e ndryshme të bazuara në situata të nxëni, reale dhe jetësore, janë një mënyrë e frytshme për motivimin dhe përmbushjen e të nxënit.
- 1.7 Është e këshillueshme që të kombinohet shpjegimi i secilës çështje, maksimum 5-10 minuta dhe kërkohet *feed-back* nga studentët, mundësisht sipas një rendi ku të gjithë të kenë mundësi të flasin.
- 1.8 Krijimi i një rutine i takimeve *on-line* një here në javë (në varësi të tipit të lëndëve dhe ciklit të studimeve).
- 1.9 *Skype* mund të përdoret si nga kompjuteri ashtu edhe nga telefoni, gjë që lehtëson aksesin në përdorim.
- 1.10 Disa ditë përpara seancës mësimore, studentëve ju dërgohen materialet që do të trajtohen (leksione të plota, *power point*, foto të materialeve video ilustruese në mënyrë të veçantë për lëndët në fushën e edukimit fizik, por jo vetëm).
- 1.11 Së bashku me materialet, dërgohet lista e çështjeve që do të trajtohen, në trajtën e rezultateve që duhet të arrihen gjatë javës. Dhënia e materialeve paraprake është shumë e rëndësishme, pasi orienton vëmendjen gjatë diskutimit.
- 1.12 Leksioni nëpërmjet *skype* dhe koha e shpenzuar është lehtësisht e verifikueshme.
- 1.13 Prezenca e studentëve për secilën thirrje, është gjithashtu e verifikueshme në çdo kohë.
- 1.14 Numri i studentëve që marrin pjesë mund të shkojë deri në 50. E rekomandueshme është gjithashtu të përdoret *Skype for web* edhe për ata që nuk e kanë të instaluar programin.

2. METODA E DISKUTIMET ON-LINE NËPËRMJET SKYPE.

Përdorimi i kësaj metode kryesisht synon të realizojë numrin e orëve të seminareve sipas programit të lëndës/modulit.

Pedagogu ndjek këto hapa:

2.1. Pedagogu dhe studentët komunikojnë *on-line* me *skype* në të njëjtin orar të caktuar si një grup i përbashkët. Gjatë diskutimeve *on-line*, pedagogu paraqet për studentët objektin e diskutimit, që mund të jenë pyetje, çështje, situata rasti, problema, ushtrime, figura, video etj., të cilat do të jenë objekt i diskutimit nga ana e studentëve. Mirë do të jetë që, me objektin e diskutimit pedagogu, t'i ketë njohur më parë studentët në komunikimet *on-line*.

2.2. Pedagogu paraqet objektin e parë të diskutimit dhe i jepet kohë e pranueshme për të menduar, për të reflektuar apo shkruar studentëve në varësi të objektit për të cilin do të diskutohet.

2.3. Pedagogu nxit diskutimin tek secili student dhe i përfshin ata në diskutime, duke bërë pyetje për të mundësuar sqarimin sa më të plotë të koncepteve, por dhe inkurajon ndërhyrjet e studentëve të tjerë, me plotësime gjatë diskutimeve të njëri-tjetrit.

2.4. Pedagogu, në përfundim të çdo objekti që është diskutuar apo trajtuar nga studentët, bën një përmbledhje shumë të shkurtër dhe vijon me objektin pasardhës të diskutimit. Këtë teknikë e përdor deri në mbarimin e të gjitha çështjeve të planifikuara për diskutim.

2.4. Kjo metodë është efikase dhe për të diskutuar rreth detyrave të kursit apo kërkesave të tjera për studentët që pedagogët kanë në programet lëndore.

3. METODA GOOGLE CLASSROOM

Përdorimi i *Google Classroom* është një metodë që duhet të fillojë të përdoret dhe në komunikimin e tanishëm *on-line* me studentët, por ky komunikim duhet zhvilluar gjatë gjithë procesit mësimor dhe në kushtet e komunikimit të drejtpërdrejtë me studentët. Instruktime të detajuara për përdorimin e *Google Classroom* gjenden në linkun:

<https://www.facebook.com/universitetimarinarbarleti/videos/496562824360180/>

Disa veprimtari mësimore që realizohen me *Google Classroom* janë:

1. **Shpërndarja e materialeve**, leksione, shënime *power point*, video nga *youtube*, artikuj, *website*, informacione etj. Procesi i shpërndarjes së tyre është i thjeshtë nga çdo burim. Mund të lihet hapësirë që, në raste të caktuara, studentët të komentojnë në lidhje me materialet.
2. Një metodë tjetër është **diskutimet/debatet në formën e blog-ut**, ku shtrohet një tezë, po një pyetje apo paraqitet një video apo film dhe secilit student i kërkohet të bëjë një koment/përgjigje mbi të.
3. Një veprimtari që ofrohet nga *Google Classroom* është edhe **Classwork**, ku të ndarë me grupe, studentët mund të punojnë mbi të njëjtën punë grupi nga shtëpitë e tyre. Kjo është një metodë e mirë për t'i nxitur grupet e studentëve të punojnë së bashku dhe të ruajnë kontaktet me njëri tjetrin.
4. Mund të ndërtohen *quiz*-e për vlerësimin e studentëve *on-line*

Gjithashtu *Google Classroom* bën të mundur dokumentimin e punës së stafit dhe të studentëve, lehtësisht e verifikueshme në çdo kohë.

Materialet që mund të futen në platformën *Google Classroom*

- a. Programet lëndore
- b. Materiale *word*
- c. *Power point*
- d. Video (nga *youtube*, te realizuara nga pedagogu)
- e. Teste / pyetje
- f. Këshilla nëpërmjet *Stream*
- g. Detyrat e studenteve
- h. Mund të shërbejë edhe si *blog* ku studentët i përgjigjen një pyetje një çështje që ngre pedagogu.

Organizimi

Organizimi do të jetë me javë, ku sipas programit lëndor, kjo platformë do të ketë të organizuar çdo javë.

*Të domosdoshme për të qënë në çdo javë në *Google Classroom*:*

- a. Temën e javës (leksionet)
- b. Çështjet që do të diskutohen gjatë takimit *online* çdo javë
- c. Konceptet kryesore
- d. Materialet burimore (*word, power point, video, pdf, etj.*)

*Të rekomanduara për të qënë cdo javë në *Google Classroom*:*

- a. Pyetje

b. Video orientuese

4.METODA ME GOOGLE HANGOUTS MEET është një formë tjetër e komunikimit dhe ndërveprimit *on-line*, e cila ka vlerë për prezantimin e leksioneve, shërben për video-konferenca, krijon mundësi që të bashkohen shumë veta në takimin virtual, ku mund të diskutohen, të prezantohen dhe të realizohen shkëmbime pyetje-përgjigje. Me anë të përdorimit të kësaj metode, mundet që të ndërveprojnë virtulisht deri në 100 studentë. Kjo metodë është e ngjashme me *Google Classroom* dhe është një mënyrë e frytshme për shpjegimin e leksioneve, si dhe të shkëmbimeve pyetje-përgjigje, gjë që lehtëson të kuptuarit e lëndës për studentët.

Kjo metodë bëhet e zbatueshme nëpërmjet dy fazave themelore, të tilla, si:

4.1. Inicijimi i një takimi me studentët

Pedagogët në këtë fazë programojnë një takim virtual dhe përcaktojnë kalendarin e takimeve.

4.2. Realizimi i takimeve virtuale

Ndjekja e takimeve virtuale realizohet me anë të takimeve të përcaktuara në *Google kalendar* ose ato të paraqitura në faqen e internetit të takimeve *Hangouts*, e cila ka një kod përdorimi për të marrë pjesë në takim.

Instruktime të detajuara për përdorimin e *Google Hangouts Meet* gjeni në linkun

<https://www.facebook.com/218003020520/posts/10163030708985521/?vh=e&d=n>

Tek të gjitha metodat e përmendura më sipër, të tilla si *Skype*, *Google Classroom*, *Google Hangouts Meet*, mund të ndiqen disa rekomandime metodologjike që marrin shkas nga dy mënyra komunikimi dhe të nxëni *on-line*, si:

- a. **Të nxënit e kombinuar** (*Blended Learning*), e cila sugjeron ndërthurjen e të nxënit tradicional, ballë për ballë, me të nxënit *on-line*. Kjo formë të nxëni dhe ndërveprimi nuk konsiderohet thjesht një teknologji mësimore *on-line*, por ajo duhet të kuptohet si një mënyrë që motivon dhe mbështet kërkesat dhe interesat e studentëve. Shumë studiues bashkëkohorë të kësaj fushe, theksojnë se kjo është një metodë të nxëni *on-line*, shumë fleksibël dhe e pranueshme, sepse ajo ruan brenda saj dimensionin e të nxënit tradicional, të nxënit ballë-për

ballë. Studiuesit kanë identifikuar se, nëpërmjet kësaj metode, studentët arrijnë rezultate të kënaqshme akademike. *Blended Learning* krijon mundësi për:

- mbështetje të studentëve për përpunimin e përmbajtjes së lëndës;
- bashkëpunim midis studentëve dhe pedagogut;
- paraqitjen e përvojave të ndryshme të të nxënit të studentëve , duke nxitur kështu motivim të nxëni;
- sigurim të angazhimit të studentëve për të nxënë.

b. Klasë e rrokullisur (*flipped classroom*), e cila ka fituar shumë popullaritet në komunikimet *on-line* pedagog-student, duke marrë vëmendje kërkimore nga studiues të ndryshëm. Ideja e “klasës së rrokullisur” është ajo e një klase që nënkupton, së pari shqyrtimin nga studentët të leksioneve që janë vendosur në internet ose që u dërgohen, më parë, atyre elektronikisht, të cilat studiohen përpara seancave *on-line*, ballë për ballë. Kërkuesit, rreth përdorimit të kësaj metode, kanë arritur në përfundimin se parapërgatitja e studentëve krijon mundësi që, në ndërveprimet *on-line*, ata të arrijnë të paraqesin të nxënit e tyre rreth koncepteve të leksioneve, të diskutojnë, të debatojnë, të japin reagime të menjëhershme, të nxitë studentët në veprimtari të nxëni që lidhen me zgjidhjen e problemeve, duke synuar nivele të larta sipas taksonomisë së Blumit. Gjithashtu, studiuesit theksojnë se, nëpërmjet kësaj forme komunikimi *on-line*, studentët krijojnë një të kuptuar më të mirë të leksioneve, përpara se të ndjekin seancat ballë për ballë dhe kjo i bën ata të jenë më të angazhuar dhe një përqendrim më të thellë në të nxënë.

5. METODA ME GRUPET E WHATSAPP

Për secilën lëndë mund të ngrihet edhe një grup *whatsapp* me qëllim ruajtjen e një kontakti më të shpejtë dhe me pothuaj të gjithë studentët. Në *whatsapp* mund të dërgohen materiale të fotografuara ose edhe leksione (përveçse edhe me *e-mail*).

6. METODA ME E-MAIL

Leksione dhe detyra nëpërmjet *e-mail* është një mënyrë e efektshme, sepse është më e lehtë për pedagogët, por krijon më pak ndërveprim me studentët, ndaj është e rekomandueshme të përdoret e kombinuar me metodat të tjera.

7. METODA WEBSITE I PEDAGOGUT

Kjo është një faqe interneti që ndërtohet nga pedagogu për të paraqitur tema dhe leksione dhe për të përcjellë informacione për studentët, por dhe për të marrë reagime nga ata. Pedagogu identifikon qartë sa herë klikohet në faqe dhe kjo është një mënyrë që studentët të nxiten për të marrë informacione në të.

8. METODA WIKIS

Wikis do të thotë i shpejtë. Ajo është një faqe interneti që studentët mund të krijojnë së bashku, që shërben për dhe rishikuar idetë dhe komentet e njëri-tjetrit dhe që i jep akses dhe pedagogut për të bërë ndërhyrjet e nevojshme në mbështetje të të nxënit. Kjo metodë nxit shumë përfshirjen e studentëve dhe motivon të nxënit.

9. METODA E VLERËSIMIT TË REZULTATEVE TË TË NXËNIT

Pedagogu në mësimdhënien *on-line* e përdor vlerësimin e studentit si shtysë për të nxënit, por dhe si matje e nivelit real të të nxënit të tyre. Disa nga teknikat me të efektshme për vlerësimin *on-line* janë:

9.1. Teste elektronike dhe *kuize on-line*, të cilat venë theksin te konceptet kryesore që duhen përvetësuar nga studenti. Testi apo *kuiz*-i duhet të ketë kryesisht pyetje me alternativa, por dhe pyetje të hapur, e cila në këtë rast kërkon një përgjigje për konceptin ose një zgjidhje për ushtrimin/problemin, jo në trajtën e një përgjigjeje shteruese, me shumë pikëpamje, gjithë teorinë, idetë, zgjidhjet e ndryshme alternative, por vetëm një përgjigje apo zgjidhje që është e saktë. Teknika teste dhe *kuiz*-e elektronike zbatohet lehtësisht në *Google Classroom*.

9.2. Portofoli digital

Portofoli digjital përgatitet nga studenti sipas kriterëve dhe kërkesave të pedagogut. Pedagogu e përdor këtë teknikë në mënyrë që studentët të paraqesin në të:

1. Literaturën e shfrytëzuar. Studentët shkruajnë në një material më vete titujt e literaturës së shfrytëzuar (bibliografi dhe webliografi), *link*-et, materialet *on-line* të lexuara ose të marra nga *youtube* etj.

2. *Esse* apo ushtrime a probleme të shkruara apo të zgjidhura nga studenti. Pedagogu e kërkon 1 - 3 produkte të tilla, që lidhen me njohuritë dhe kompetencat më të rëndësishme, që synon të krijojë studenti nëpërmjet përmbajtjes së programit lëndor.

3. Detyrat e kursit apo detyrime të tjera, sipas programit lëndor.

Portofoli është një teknikë vlerësimi që synon ta mbajë studentin në gjendje të nxëni dhe pedagogu mund të japë pikë ose notë *bonus* për këtë produkt. Portofoli i dërgohet pedagogut me *e-mail* në versionin *pdf*.

9.3. Është e këshillueshme që të jepen 1 herë në 3 leksione detyra të veçanta, të cilat të kenë vlerësim me pikë apo me notë. Ky sugjerim jepet sepse, nëse vijon gjatë mësimi *on-line*, në këtë mënyrë kemi të dokumentuar një tufë detyrash që lehtësojnë vlerësimin përfundimtar të studentit. Kjo mënyrë vlerësimi bazohet në copëzimi i lëndës në pjesë dhe në to, identifikohen konceptet dhe aftësitë më të domosdoshme që duhet të zotërojnë studentët, në përfundim të saj.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I MËSIMDHËNIES ON-LINE.

Nëpërmjet *Google Form* mund të kryhet një proces monitorimi në fund të çdo jave, ku secili prej pedagogëve të mund të shpjegojë mënyrën që ka zgjedhur për mësimdhënien *on-line*.

Po nëpërmjet *Google Form* studentët mund të pyeten në lidhje me procesin e mësimdhënies *on-line*, aspektet pozitive dhe nevojat për përmirësim.

Të dhënat e mbledhura përpunohen në kohë reale nga *Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë* për të ndjekur procesin mësimor dhe për të përmirësuar më tej atë. Të dhënat e mbledhura ju dërgohen autoriteteve drejtuese të UMB (*Rektorit, Administratorit të Deleguar, Zëvendës Rektores Akadematike, Koordinatorës së Vlerësimit të Performancës*, sipas përcaktimeve).

GRUPI I PUNËS I EDUKIMIT

Tiranë, më 30.03.2020